



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 1126/11 Prot.

Patos më, 30/04/2019

Lënda: Informacion

QENDRËS “RES PUBLICA”

Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap 44

Bazuar në kërkesën me Nr. 1126 Prot, datë 23.04.2019, bërë nga Qendra “Res Publica” lidhur me kërkesën e një qytetari për tu informuar në lidhje me projektet që Bashkia Patos ka përfituar në programin “Rilindja Urbane” ju informojmë si më poshtë:

“Përgjatë periudhës 2014-2018, Bashkia Patos ka fituar një sërë projektesh të rëndësishme në programin “Rilindja Urbane”, të cilat janë të listuara më poshtë:

- Rikualifikim Urban i “Shëtitorës Republika”, Patos
- Rikonstruksion i Rrugës “Unaza”, Patos
- Rikonstruksion i Rrugës “Shën Maria”, Sheqishte
- Rikonstruksion i Rrugës “Ruzhdie- Gjinoqar”
- Rikonstruksion i shkollës së mesme “Zhani Ciko”, Patos
- Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Meleq Gostinishti”, Patos
- Rikonstruksion i shkollës së bashkuar “Mustafa Matohiti”

Bashkangjitur kësaj liste projektesh po ju dërgojmë në rrugë elektronike në adresën qendra.respublica@gmail.com një kopje të dokumentacionit që lidhet me zbatimin e këtyre projekteve, përkatësisht kopje të kontratave të sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes së objekteve. Përjashtim në këtë dokumentacion bën projekti “Rikonstruksioni i shkollës “Mustafa Matohiti”, i cili është në procedurë tenderimi.



KRYETARE

Rajmonda BALILAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 6831 / Prot
114

Patos, më 03/11 /2016

KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :

"Rikualifikim Urban i Shetitores Republika"

Drejtuar : _____

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS
- ❖ KONTRAKTOR : "Shoqeria **"ED KONSTRUKSION"** sh.p.k Tirane ne kontrate bashkepunimi me shoqerine **"FUSHA"** sh.p.k Tirane dhe **"ARKONSTUDIO"** sh.p.k Tirane



40

KONTRATE SIPERMARRJE

“Rikualifikim Urban i Shetitores Republika”

Lidhur sot më, 03/11/2016 (dy mijë e gjashtembedhjete) midis **Bashkise Patos** perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise **znj.Rajmonda Balilaj** nga njera anë dhe bashkimit te shoqerive **“ED KONSTRUKSION”** sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z. Alfred Ibrahim**, shoqerine **“FUSHA”** sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z. Shkelqim Fusha**, **“ARKONSTUDIO”** sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z.Krenar Dila** nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PËRKUFIZIME:

“Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes.

“Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes.

“Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve, e vertetuar nga enti prokurues, konkretisht ky afat është 8 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

“Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

“Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

“Data e fillimit” eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

“Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

“Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ne objektin **“Rikualifikim Urban i Shetitores Republika”**.

“Palë(t)” do të thotë nënshkrimet e kontratës e konkretisht.

“Drejtes projekt” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

“Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakon punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar ne ligj.

“Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

“Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

“Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

“Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet, konkretisht është bashkimi i shoqërive, shoqëria “**ED KONSTRUKSION**” sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z. Alfred Ibrahim** rregjistruar prane QKR si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me nr. Nipt-i K616250011, “**FUSHA**” sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z. Shkelqim Fusha** rregjistruar prane QKR si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me nr. Nipt-i J61922018S dhe shoqëria “**ARKONSTUDIO**” sh.p.k Tirane perfaqesuar nga **Z.Krenar Dila** rregjistruar prane QKR si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me nr. Nipt-i L42019004I.

“Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të perkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

“Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

“Llogaritja e afateve” do të thotë që të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

“Afati i Garancise se Punimeve” do të thotë periudha prej 24 muaj e cila fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilës Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt që ka ardhur si pasojë e cilësisë së punimeve të kryer prej tij.


“Garancia e Punimeve”, eshte vlera prej 5% e vlefes së situacionit përfundimtar të miratuar.

Neni 1: Objekti i kontrates

“**Rikualifikim Urban i Shetitores Republika**” sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.
Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 2: Vlefte dhe afati i kontrates

Vlefte e fituar ne tender per përfundimin e punimeve ne total eshte **96,285,666 (nentedhete e gjashte milion e dyqind e tetedhete e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhete e gjashte) leke me TVSH** dhe afati i kryerjes se punimeve eshte **8 muaj**.



Fondi per realizimin e punimeve eshte vene ne dispozicion nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve. Prokurimi i ketij Objekti behet me vlere te plote.

Kontraktori eshte i detyruar te perfundoje te gjitha punimet (volumet e parashikuara ne preventiv) sipas afateve te zbatimit te punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve perkatese.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

Neni 3: Hartimi i kontrates

Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial


Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 6: Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkëmbim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prona tjetër sipas kontratës.



Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor


Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur këto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

Kontraktori pranon se ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose kostot e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që kryen Punimet



Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë proces verbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit



Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor


Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Neni 23.

Neni 25: Sigurimi



416

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumën e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky sigurim duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë sigurimin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e sigurimit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kërkuara sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.



Neni 29: Kushtet e Pagesës

Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklarohet se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit



Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përgjeshjes së kontraktorit.



- 10 -



fusha
Tiranë
Tel/fax: +355 4 281 760

418

Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruar në amendamentet e marrveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njesi ose në Total


Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.



Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesëve të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Transferimi i të Drejtave


Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 43: Sigurimi i Kontrates

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Sigurimi i kontrates do t'i kërket kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.



Neni 44: Te drejtat dhe detyrat e AK

Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Patos do te vendosen si perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposhtme :

– Mbikqyresi i punimeve _____

te marre te gjitha masat per gatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.

Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.

Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.

Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.

Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit origjinal te kontrates.

Autoriteti Kontraktor ne çdo kohe, mund te porosisë kontraktorin te bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- d) Korrigjime në materiale
- e) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.


Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyresi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikqyresin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundshme dhe mandej i miraton ato.

Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.

Te vëri ne shfrytëzim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.



Verifikon kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- c) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- d) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 45: Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit

Te siguroj Kontraten ne vleren **10%** te vlefte totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.

Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.

Me marrjen e Objektivit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit ne dorezim.**

Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike per aktivitetet e Punimeve.

Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.

Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.

Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **45** dite kalendarike.

Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.

Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.

Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsytet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rean e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**



Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.

Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambientit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likujdimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Sitauacionet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.

Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.

Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.

T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerite specifikesht sipas vertetimeve bankare qe do te paraqesin.

Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.

Neni 46: Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 47: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 48: Përfaqësimi i Palëve

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.



Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 49: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 50: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo Kontrate hartohet në 5(pese) kopje, 2(dy) për Kontraktorin dhe 3(tre) për Bashkinë Patos dhe pasi lexohet nga palet, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire në Patos sot me datë 03/11/2016.

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Naftëtari",

Rruga "Unaza" Patos

Tel: 0381 22372; 23664

Adresa :

"ED KONSTRUKSION" sh.p.k Tirane me adrese si me poshte:

Rruga Frederik Shiroka, kulla C, kati i 2, ap1/2

"ARKONSTUDIO" sh.p.k Tirane, Njesia Bashkiake nr.7, rruga "Frosina Plaku", Pallati nr.21, Shkalla A, Apartamenti nr. 5

"FUSHA" sh.p.k Tirane, Sauk

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Rajmonda BALILAJ
KRYELIARI I BASHKISË



"Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

"ED KONSTRUKSION" sh.p.k


Alfred IBRAHIMI
ADMINISTRATOR



"ARKONSTUDIO" sh.p.k

Krenar DILA
KONTRAKTOR

"FUSHA" sh.p.k



Shkelqim FUSHA
ADMINISTRATOR

Perfaqësuar me prokurë të posacme
date 01/11/2016 nga Vladimir Xhaferi

fusha
tel/fax ++355 4 354 780



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 1535 / Prot.

Patos, më 28/10/2016

K O N T R A T Ë

Mbi mbikqyrjen e punimeve per objektin

"Rikualifikim Urban i Shetitores Republika"

Sot, më 28, 10, 2016, bazuar ne ligjin Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", U.K.M.nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", ne VENDIM Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM ", ne U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.51 date 26/12/2015 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Patos per vitin 2016", në Udhëzimin nr.3 datë 27/01/2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla", në Urdhrin e Prokurimit nr.21 datë 31/08/2016 si edhe në kontratën qe do te lidhet me shoqerine "ED KONSTRUKSIONshpk Tirane & ARKONSTUDIO shpk Tirane & FUSHA shpk Tirane lidhet kjo kontratë për caktimin e mbikqyrësit të punimeve me përmbajtjen si vijon:

Neni 1


PALET KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata për caktimin dhe detyrat e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit për objektin "Rikualifikim Urban i Shetitores Republika", midis investitorit Bashkia Patos e perfaqesuar prej Kryetares së saj njëkohesisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe shoqërive "REAN 95"shpk Tirane me nr.Nipt-i J61827043V perfaqesuar nga Ing.Razije Naipi e licensuar me nr.licence MK.1506/6 dt.01/08/2016 & shoqeria "DRICONS" shpk Tirane me nr Nipti L52013020H perfaqesuar nga Ing.Vladimir Topi, e licensuar me nr.licence MK.1761/1 dt.21/04/2009 e cili rezultoi fituese nga procedura elektronike tender "Kerkese per propozim" i zhvilluar më datë 16/09/2016 ora 11:00, e cila me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyrën e ngarkuar të mbikqyrësit të punimeve të ndertimit, prej bashkepunimit te firmave fituese të tenderit shoqerine "ED KONSTRUKSION"shpk Tirane perfaqesuar nga Alfred Ibrahim & ARKONSTUDIO" shpk Tirane perfaqesuar nga Krenar Dila & FUSHA shpk Tirane perfaqesuar nga Shkelqim Fusha .

Neni 2

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate janë marrëdhëniet juridike qe krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e punimeve të ndërtimit për objektin



429

“Rikualifikim Urban i Shetitores Republika”. Në këtë kontratë përcaktohet baza ligjore e aktivitetit të mbikqyrësit të punimeve, detyrat dhe të drejtat e palëve.

Neni 3 **BAZA LIGJORE**

Palët kontraktuese janë të angazhuara të zbatojnë me rigorozitet dispozitat e vendosura në ligjin nr. 8402 dt.10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, VENDIM Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM “ si edhe gjithë aktet e tjera ligjore të cilat nuk janë shprehimisht të cituara në këtë kontratë .

Neni 4 **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS**

Bashkia Patos me cilësinë e investitorit ka për detyrim ndaj mbikqyrësit të punimeve:

- 1- Të lirojë e dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen .
- 2- Të vërë në dijeni mbikqyrësin për të gjitha ndryshimet që mund të pësojë dokumentacioni teknik, si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej mbikqyrësit .
- 3- Të bëjë pagesën e plotë të mbikqyrësit të shoqërive “REAN 95” shpk Tirane me nr.Nipt-i J61827043V perfaqesuar nga Razije Naipi” e licensuar me nr.liçence MK.1506/6 dt.01/08/2016& “DRICONS” shpk Tirane me nr Nipti L52013020H, në shumën **624,000(gjashtëqind e njetete e kater mije)**leke me **TVSH**.
- 4- Të vërë në dijeni mbikqyrësin e punimeve për nënkontraktoret e mundshëm që mund të zgjedhë sipërmarrësi për të realizuar punimet .

Po kështu investitori ka të drejte :

- 1 – Të kërkojë në çdo kohë informacion mbi bazën e akteve të përpiluara nga mbikqyrësi i punimeve për punët në objekt.
- 2 – Të zëvendësojë mbikqyrësin e punimeve kur verëhen mangësi serioze në veprimtarinë e tij.

Neni 5 **TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE**

Mbikqyrësi i punimeve në të gjithë veprimtarinë e tij do të bazohet në aktet ligjore të lartpërmendura, si edhe në kërkesat e kësaj kontrate ku vecojmë :

Mbikqyrësi i punimeve ka të drejta :

- 1 – Të fillojë punë pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit tek sipërmarrësi .
- 2 – Të marrë shpërblimin pas çdo situacioni të dorëzuar tek investitori .
- 3 – Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet .
- 4 – Të kërkojë prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit .

Po kështu mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë :

- 1 – Të ndjekë nga afër çdo punim që bëhet prej sipërmarrësit në objekt, në çdo fazë të



[Handwritten signature]

- 2 - Të mbajë konform Udhëzimit nr.3 dt.15/02/2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në cdo moment që i kërkohet prej investitorit .
- 3 - Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentave që pasqyrohen atje.
- 4 - Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kërkuara për kantierin në përputhje me kërkesat e rregullave të prokurimit të sanksionuara në pikën 6.1 të shtojcës 15 të DST, licencën e sipërmarrësit, verifikimin e sheshit të ndërtimit, njohjen e kontratës së sipërmarrjes, vendosjen e tabelës së identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin përkates (pika 6 e Udhëzimit nr 3 dt.15.2.2001)
- 5 - Të bëjë informimin me shkrim njëherë në muaj dhe rast pas rasti për të gjitha masat e marra prej tij gjatë zbatimit të projektit të punimeve prej sipërmarrësit, cilësinë e materialeve të përdorura në punime, për masat me karakter administrativ që i ka propozuar për t'i marrë sipërmarrësi, verifikimet përkatëse që ka kërkuar në raste të defekteve në punime etj.
- 6 - Të mos lejoje asnjë punim të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Në rast të kundërt duhet të ndërmarrë inisiativen e nevojshme që i lejon ligji dhe aktet nënligjore të lartepërmendura për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.
- 7 - Të kerkoje prej sipërmarrësit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me përfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal për dorëzimin e dosjes së punimeve.
- 8 - Të mbajë kontakte të vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe të marrë pjesë në kolaudimin e vepres së përfunduar. Të firmose gjithshka që ka miratuar duke vlerësuar se mban përgjegjësi ligjore për këto akte.
- 9 - Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, dhe pas kësaj ato vlerësohen të vlefshme për t'u bërë pagesa përkatëse.
- 10 - Pas përfundimit të kolaudimit percakton vlerën përfundimtare të objektit që i jepet për likuidim investitorit.
- 11- Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori ,mbikqyresi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të vepres. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe ben ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve .

Neni 6
SANKSIONET

Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbahen kushteve të kësaj kontrate dhe të respektojnë të gjithë legjislacionin e lartepërmendur. Mos zbatimi dhe shkeljet që mund të ndodhin gjatë periudhës së punimeve i ngarkon palët me sanksione dhe deri në zgjidhjen e kësaj kontrate .

Neni 7
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët e përfshira në këtë kontratë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në rast se nuk do të mundin t'i zgjidhur ato, me mirëkuptim.

Neni 8

Projektim - Mbikqyrje - Kolaudim
"REAN 95" Shpk
Konsulence, VN, Mijarsat, ANZ



DISPOZITA TE FUNDIT

Kjo kontratë fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nënshkrimit të saj prej palevë pjesëmarrëse.
Kontrata përpilohet në 5(pese) kopje ku njëra depozitohet në dosjen e tenderit, një kopje pranë Mbikqyresit të punimeve, një kopje pranë sipërmarrësit dhe dy kopje në Drejtorinë e Finances pranë Bashkisë Patos .

MBIKQYRESI I PUNIMEVE

Shoqeria "DRICONS" shpk Tirane
Nr.Lic MK .1761/1 date 21.04.2009
perfaqesuar nga Ing.Vladimir Topi
& REAN 95" shpk Tirane
Nr.Lic. MK.1506/6 dt.01/08/2016
Perfaqesuar nga Ing.Razije Naipi

Projektim - Mbikqyrje - Kolaudim
"REAN 95" shpk
Konsulence.VN.Miqosor - MNZ



INVESTITORI
BASHKIA PATOS
KRYETARE
Rajmonda BALHAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Nafitari", Rruga "Unaza"

Nr. 1718/10 Prot

Patos, më 20/04 /2017

KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :

"RIKONSTRUKSION I RRUGES UNAZA"

Drejtuar : _____

PALËT :

❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS

▸ KONTRAKTOR : Shoqeria "G.P.G Company" shpk Lushnje



KONTRATE SIPERMARRJE

“Rikonstruksion i rruges Unaza”

Lidhur sot më, 20/Prill / 2017 (dy mijë e shtatembedhjete) midis **Bashkise Patos** perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise **znj.Rajmonda Balilaj** nga njera anë dhe shoqerise **“G.P.G Company”**, perfaqesuar nga **Z.Paqsor Buzi** nga ana tjetër, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PËRKUFIZIME:

“Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes.

“Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes.

“Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve, e vertetuar nga enti prokurues, konkretisht ky afat është 45 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

“Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

“Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

“Data e fillimit” eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.


“Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

“Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.


“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ne objektin **“Rikonstruksion i rruges Unaza”**

“Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës e konkretisht.

“Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.



2 -



1813

“Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe qe kontrakon punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

“Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

“Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

“Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

“Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet, konkretisht është shoqëria “G.P.G Company”shpk Lushnje perfaqesuar nga **Z.Paqsor Buzi** .“Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

“Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

“Llogaritja e afateve” do të thotë që të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

“Afati i Garancise se Punimeve” do të thotë periudha prej 20 muaj e cila fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilës Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt që ka ardhur si pasojë e cilësisë së punimeve të kryer prej tij.

“Garancia e Punimeve”, eshte vlere prej 5% e vlefes së situacionit përfundimtar të miratuar.

Neni 1 : Objekti i kontrates

“**Rikonstruksion i rruges Unaza**”sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 2 : Vlefte dhe afati i kontrates

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte **147,146,844(njeqind e dyzete e shtate milion e njeqind e dyzete e gjashte mije e teteqind e dyzete e kater)leke me TVSH**, dhe afati i kryerjes se punimeve eshte **10(dhjetë) muaj ”**

Fondi per zhvillimin e ketij objekti bazohet ne Vendimin nr.31 datë 13/06/2016 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve prokurohet me vlerë të plotë per vitin 2017.Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse pavarësisht financimit.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vlefte totale te mesiperme perfaqesuar TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.



Neni 3: Hartimi i kontrates

Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 6: Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve



Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit



Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.



Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin. Gjithashtu kontraktori duhet të vendos në kantierin e punimeve tabelen me të dhenat kryesore të punimeve që do të kryhen.

Neni 17: Zbulimet


Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.



Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:



- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantiër deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumën e shprehur në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantiërit ose pronave të tjera në kantiër dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.



Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspekte.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës



8



Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provoje ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit



Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.


Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.



Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njesi ose në Total


Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimit, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japë udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.



Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesës së Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Transferimi i të Drejtave

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 43: Sigurimi i Kontrates

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.



Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 44: Te drejtat dhe detyrat e AK

Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Patos do te vendosen si perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposhtme :

– Mbikqyresi i punimeve _____

te marre te gjitha masat per gatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.

Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.

Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.

Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektivit.

Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektivit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuar në LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:


- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- d) Korrigjime në materiale
- e) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrevshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrvshjes.

Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor



ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.

Te vëri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.

Verifikon kryrjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eleminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- c) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- d) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 45: Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit

Te siguroj Kontraten ne vleren **10%** te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.

Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.

Me marrjen e Objektit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektit ne dorezim.**

Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.

Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.

Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **10(dhjete)muaj**.

Te pranoj cdo ndryshim jo thellesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.

Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.

Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti



Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**

Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.

Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Sitacionet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.

Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.

Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.

T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerite specifikesht sipas vertetimeve bankare qe do te paraqesin.

Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.

Neni 46: Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 47: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 48: Përfaqësimi i Palëve



Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 49: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 50: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo Kontrate hartohet ne 5(pese) kopje, 2(dy) per Kontraktorin dhe 3(tre) per Bashkine Patos dhe pasi lexohet nga palet, nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Patos sot me date 20/04/2017

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Naftëtari",

Tel: 0381 22372; 23664


Adresa :

"G.P.G Company" shpk Lushnje" me adrese: Fier Lushnje, Lushnje, Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut

"G.P.G Company" shpk Lushnje" Cel:069 20 80 852

Për dhe në emër të :

**AUTORITETIT KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS**


Rajmonda BALILAJ

KRYETARE E BASHKISE

Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

Shoqeria "G.P.G Company" shpk Lushnje


"G.P.G Company" shpk Lushnje

Paqor BUZI





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 322 / Prot. 13

Patos, më 20/04 /2017

K O N T R A T Ë

Mbi mbikqyrjen e punimeve per objektin

"Rikontruksion i rruges "UNAZA"

Sot, më 20, 04, 2017, bazuar ne ligjin Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", U.K.M.nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", ne VENDIM Nr.354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM ", ne U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.57 date 26/12/2016 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Patos per vitin 2017", në Udhëzimin nr.3 datë 27/01/2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla", në Urdhrin e Prokurimit nr.9 datë 10/02/2017 si edhe në kontratën qe do te lidhet me shoqerine "G.P.G shpk Lushnje lidhet kjo kontratë për caktimin e mbikqyrësit të punimeve me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

PALET KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata për caktimin dhe detyrat e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit për objektin "Rikontruksion i rruges "UNAZA", midis investitorit Bashkia Patos e perfaqesuar prej Kryetares së saj njëkohesisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe "shoqerise "DRICONS" shpk Tirane me nr Nipti L52013020H perfaqesuar nga Ing.Vladimir Topi, e licensuar me nr.license MK.1761/1 dt.21/04/2009 e cili rezultoi fituese nga procedura elektronike tender "Kerkese per propozim" i zhvilluar më datë 23/02/2017 ora 11:00, e cila me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyrën e ngarkuar të mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, prej bashkepunimit te firmave fituese të tenderit shoqerine "G.P.G shpk Lushnje perfaqesuar nga Paqsor Buzi .

Neni 2

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate janë marrëdhëniet juridike qe krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e punimeve të ndërtimit për objektin "Rikonstruksion i rruges Unaza". Në këtë kontratë përcaktohet baza ligjore e aktivitetit të mbikqyrësit të punimeve, detyrat dhe të drejtat e palëve.

Neni 3

BAZA LIGJORE

Palët kontraktuese janë të angazhuara të zbatojnë me rigorozitet dispozitat e vendosura ne ligjin nr. 8402 dt.10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",



230

Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, VENDIM Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORIAL, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM " si edhe gjithë aktet e tjera ligjore të cilat nuk janë shprehimisht të cituara në kete kontrate .

N e n i 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS

Bashkia Patos me cilësinë e investitorit ka për detyrim ndaj mbikqyrësit të punimeve:

- 1- Të lirojë e dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen .
- 2- Të vërë në dijeni mbikqyrësin për të gjitha ndryshimet që mund të pësojë dokumentacioni teknik, si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej mbikqyrësit .
- 3- Të bëjë pagesën e plotë të mbikqyrësit shoqërisë "DRICONS" shpk Tirane me nr Nipti L52013020H, në shumën **1,430,400 (një milion e katërqind e tridhjetë mijë e katërqind) leke me TVSH.**
- 4- Të vërë në dijeni mbikqyrësin e punimeve për nënkontraktoret e mundshëm që mund të zgjedhë sipërmarrësi për të realizuar punimet .

Po kështu investitori ka të drejte :

- 1 – Të kërkojë në cdo kohë informacion mbi bazën e akteve të përpiluara nga mbikqyrësi i punimeve për punët në objekt.
- 2 – Të zëvendësojë mbikqyrësin e punimeve kur verëhen mangësi serioze në veprimtarinë e tij.

N e n i 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE


Mbikqyrësi i punimeve në të gjithë veprimtarinë e tij do të bazohet në aktet ligjore të lartpërmendura, si edhe në kërkesat e kësaj kontrate ku vecojmë :

Mbikqyrësi i punimeve ka të drejta :

- 1 – Të fillojë punë pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit tek sipërmarrësi .
- 2 – Të marrë shpërblimin pas cdo situacioni të dorëzuar tek investitori .
- 3 – Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet .
- 4 – Të kërkojë prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit .

Po kështu mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë :

- 1 – Të ndjekë nga afër cdo punim që bëhet prej sipërmarrësit në objekt, në cdo fazë të tij
- 2 – Të mbajë konform Udhëzimit nr.3 dt.15/02/2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në cdo moment që i kërkohet prej investitorit .
- 3 – Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentave që pasqyrohen atje.
- 4 – Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kërkuara për kantierin në përputhje me kërkesat e rregullave të prokurimit të sanksionuara në pikën 6.1 të shtojcës 15 të DST, licencën e sipërmarrësit, verifikimin e sheshit të ndërtimit, njohjen e kontratës së sipërmarrjes, vendosjen e tabelës së identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin përkatës (pika 6 e Udhëzimit nr 3 dt.15.2.2001)



- 231
- 5 – Të bëjë informimin me shkrim njëherë në muaj dhe rast pas rasti për të gjitha masat e marra prej tij gjatë zbatimit të projektit të punimeve prej sipërmarresit, cilësinë e materialeve të përdorura në punime, për masat me karakter administrativ që i ka propozuar për t'i marrë sipërmarresi, verifikimet përkatëse që ka kërkuar në raste të defekteve në punime etj.
- 6 – Të mos lejoje asnjë punim të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Në rast të kundërt duhet të ndërmarrë inisiativen e nevojshme që i lejon ligji dhe aktet nënligjore të lartepërmendura për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.
- 7 – Të kerkoje prej sipërmarresit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me perfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal për dorëzimin e dosjes së punimeve.
- 8 - Të mbaje kontakte të vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe të marrë pjesë në kolaudimin e vepres së perfunduara. Të firmose gjithshka që ka miratuar duke vlerësuar se mban përgjegjësi ligjore për këto akte.
- 9 – Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarresi, dhe pas kësaj ato vlerësohen të vlefshme për t'u bërë pagesa përkatëse.
- 10 - Pas perfundimit të kolaudimit përcakton vlerën perfundimtare të objektit që i jepet për likuidim investitorit.
- 11- Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori ,mbikqyresi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin perfundimtar të vepres. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve .

Neni 6 **SANKSIONET**

Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbahen kushteve të kësaj kontrate dhe të respektojnë të gjithë legjislacionin e lartepërmendur. Mos zbatimi dhe shkeljet që mund të ndodhin gjatë periudhës së punimeve i ngarkon palët me sanksione dhe deri në zgjidhjen e kësaj kontrate .


Neni 7 **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Palët e përfshira në këtë kontratë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në rast se nuk do të mundin t'i zgjidhin ato, me mirëkuptim.


Neni 8 **DISPOZITA TE FUNDIT**

Kjo kontratë fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nënshkrimit të saj prej palevë pjesëmarrëse. Kontrata përpilohet në 5(pese) kopje ku njëra depozitohet në dosjen e tenderit, një kopje pranë Mbikqyresit të punimeve, një kopje pranë sipërmarresit dhe dy kopje në Drejtorinë e Finances pranë Bashkisë Patos .

MBIKQYRESI I PUNIMEVE
Shoqeria "DRICONS" shpk Tirane
Nr.Lic MK .1761/1 date 21.04.2009
perfaqesuar nga Ing.Vladimir Topi



INVESTITORI
BASHKIA PATOS
KRYETARE
Rajmonda BALILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 1478/12 Prot

Patos, më 30/12, /2016

KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :

"RIKONSTRUKSION I RRUGES "SHEN MARIA" Sheqishte

Drejtuar : _____

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS
- KONTRAKTOR : "VARAKU E" shpk Durres



KONTRATE SIPERMARRJE

"Rikonstruksion i rruges "SHEN MARIA" Sheqishte

Lidhur sot më, 30 /Dhjetor / 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjete) midis Bashkise Patos perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise znj. Rajmonda Balilaj nga njera anë dhe shoqerise "VARAKU E" shpk Durres me nr.Nipt-i J61902509S perfaqesuar nga Z. Shpetim Varaku nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PËRKUFIZIME:

"Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes.

"Preventiv për njësi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes.

"Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve, e vertetuar nga enti prokurues, konkretisht ky afat është 45 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

"Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

"Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.

"Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

"Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

"Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

"Data e fillimit" eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

"Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

"Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

"Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ne objektin "Rikonstruksion i rruges"Shen Maria" Sheqishte.

"Palë(t)" do të thotë bashkruesit e kontratës e konkretisht.

"Drejtues i objekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.



"Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe qe kontrakon punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar ne ligj.

"Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.

"Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit qe pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

"Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, qe furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

"Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik qe është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet, konkretisht është shoqëria "VARAKU E" shpk Durres perfaqesuar nga Z.Shpetim Varaku rregjistruar pranë QKR me date 23/08/1994 si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me nr. Nipt- J61902509S.

"Standarde Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

"Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të perkohshme, të ndërtuara e instaluara, qe janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

"Punime" do të thotë ajo qe Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

"Llogaritja e afateve" do të thotë qe të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

"Afati i Garancise se Punimeve" do të thotë periudha prej 20 muaj e cila fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilës Kontraktori riparon me shpenzimet e tij çdo difekt qe ka ardhur si pasojë e cilësisë së punimeve të kryer prej tij.

"Garancia e Punimeve", është vlera prej 5% e vlefes së situacionit përfundimtar të miratuar.

Neni 1 : Objekti i kontrates

Rikonstruksion i rruges "Shen Maria" Sheqishte sipas Projektit. Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 2 : Vlefte dhe afati i kontrates

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte 48,095,019(dyzete e tete milion e nentendhete e pese mije e nentembedhete) leke me TVSH. dhe afati i kryerjes se punimeve eshte 3(tre) muaj .

Prokurimi i këtij Objekti në bazë të Vendimit nr.10 datë 10/03/2016 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve prokurohet me vlerë të plotë për vitin 2016 financimi do të jetë me vlerë 27,830,438(njezete e shtate milion e teteqind e tridhete mije e katerqind e tridhete leke me TVSH, kurse pjesa qe mbehet do te likujdohet ne vitin 2017 Kontraktori është detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe të form specifikimeve teknike dhe standarteve perkatëse pavarësisht financimit.



Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vlefsten totale të mesiperme përfshihet TVSH, si dhe të gjitha detyrimet e tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3: Hartimi i kontrates

Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 6: Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se krijohet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale, kontraktori nga zbatimimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo



prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose kalimin e Punëve.

Neni 13: Kontraktori kryen Punimet



Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin. Gjithashtu kontraktori duhet të vendos në kantierin e punimeve tabelen me të dhenat kryesore të punimeve që do të kryhen.

Neni 17: Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendime të kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Trafikut të Zbatimit



Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës. Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas...

Neni 25: ...

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e fillimit të punës në Kantierin në Afatin e Realizimit të Plote, në shumat e shprehura në KYK për



humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në kushtet e kontratës.

Neni 29: Kushtet e Pagesës



Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.


Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllime të këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit



Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.


Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbejnë objektin e përzgjedhjes së kontraktorit.



Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njese ose në Total


Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njese nëse është një kontratë me çmim njesisë. Nëse është një kontratë me çmim njesisë, Preventivi për Njese do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi për Njese do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njese për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do të bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbaton se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime të shkrimit kontraktit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.



Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesëve të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Transferimi i të Drejtave

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 43: Sigurimi i Kontrates

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.



Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 44: Te drejtat dhe detyrat e AK

Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Patos do te vendosen si perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposhtme :

- Mbikqyresi i punimeve _____

te marre te gjitha masat per gatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.

Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.

Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.

Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.

Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit origjinal te kontrates.

Autoriteti Kontraktor ne çdo kohë, mund te porosisë kontraktorin te bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- d) Korrigjime në materiale
- e) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

Nëse volumni i punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor



ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

Te marre ne dorezim Objektiv pas kolaudimit perfundimtar.

Te vëri ne shfrytezim Objektiv dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.

Verifikon kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

c) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë, ose,

d) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 45: Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit

Te siguroj Kontraten ne vleren 10% te vlefte totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te marre ne dorezim Objektiv duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.

Me marrjen e Objektivit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit ne dorezim.**

Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.

Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.

Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **3(tre)muaj**.


Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.

Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimin te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.

Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyt e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë.

Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti



Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e eilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**

Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.

Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likujdimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.

Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.

Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.

T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditësuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojnë ne dosjen e Objektit.

Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerite specifikesht sipas vertetimeve bankare qe do te paraqesin.

Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.

Neni 46: Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 47: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 48: Përqendrimi Palëve



Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 49: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 50: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo Kontrate hartohet në 5(pese) kopje, 2(dy) për Kontraktorin dhe 3(tre) për Bashkinë Patos dhe pasi lexohet nga palët, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire në Patos sot me datë 30/12/2016

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Naftëtari"
Rruga "Unaza" Patos

Tel: 0381 22372; 23664

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA PATOS

Rajmorda BALIL



Adresa :

"Varaku E" shpk Durres me adrese Durres fshati Xhafzotaj

Cel 068 20 31 982 Fax:052/260591

Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

Shoqeria "VARAKU E" shpk Durres

"VARAKU E" sh.p.k Durres
Shpetim Varaku





REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
Njësia e Prokurimit

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza";

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: "RIKONSTRUKSION I RRUGES "SHEN MARIA" Sheqishte

Nr. i Referencës së Kontratës se Siper marrjes : REF-17 dt 12/08/2016

Kjo Kontratë është lidhur më 30 / 12 / 2016 (dy mijë e gjashtembedhjete), midis Bashkise Patos perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise znj.Rajmonda Balilaj nga njera anë dhe shoqerise "VARAKU E" shpk Durres perfaqesuar nga Z.Shpetim Varaku nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

Menjehere pasi Kontraktori, me ane te ofertës së tij, me datë 19/09/2016 bie dakord të kryeje punimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:


- këtë Formular Kontrate
- Formulari i Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjehere pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë me TVSH prej 48,095,019(dyzete e tete milion e nentehjete e pese mije e nentembedhjete) leke me TVSH.

Palët bien dakort si më poshtë :

1.Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: 10 % te vleres se kontrates dhe në formën e: garanci bankare ose siguracion prane shoqerive te licensuara, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

2.Kontraktuesi është i detyruar të kryeje Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.



3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 30/12/2016 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Naftëtari",
Rruga "Unaza" Patos

Tel: 0381 22372; 23664

Adresa :

"Varaku E" shpk Durres me adrese : Durres fshati Nhafzotaj


Cel: 068 20 31 982 Fix: 052/260591

Për dhe në emër të :

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA PATOS


Rajmonda BALILA

PRATEFTERË I NDIKIMIT



KONTRAKTORI

Shoqeria "VARAKU E" shpk Durres

"VARAKU E" sh.p.k Durres
Shpetim Yvaraku





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 1478 / Prot.

Patos, më 28/12, 2016

KONTRATË

Mbi mbikqyrjen e punimeve per objektin
"Rikonstruksion i Rrugës "Shen -Maria,Sheqishte.

Sot, më 28/12 /2016, bazuar ne ligjin Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", U.K.M.nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", ne V.K.M. Nr. 354, datë 11.5.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", ne U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.51 date 26/12/2015 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Patos per vitin 2016", në Udhëzimin nr.3 datë 27/01/2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla", në Urdhrin e Prokurimit nr.142 datë 16/12/2016 si edhe në kontratën qe do te lidhet me shoqerine "VARAKU-E shpk Durres, lidhet kjo kontratë për caktimin e mbikqyrësit të punimeve me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

PALET KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata për caktimin dhe detyrat e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit për objektin "Rikonstruksion i Rrugës "Shen -Maria,Sheqishte." midis investitorit Bashkia Patos e perfaqesuar prej Kryetares së saj njëkohesisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe shoqërise "REAN 95" shpk Tirane me nr Nipti J61827043V perfaqesuar nga Ing.Razije Naipi e licensuar me nr.liçence MK.1506/6 dt.01/08/2016 e cili rezultoi fituese nga procedura elektronike blerje me vlera te vogel i zhvilluar më datë 22/12/2016 ora 11:00, e cila me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyrën e ngarkuar të mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, prej firmes fituese të tenderit shoqerine "VARAKU-E shpk Durres.

Neni 2


OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate janë marrëdhëniet juridike qe krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e punimeve të ndërtimit për objektin "Rikonstruksion i Rrugës"Shen -Maria,Sheqishte. Në këtë kontratë përcaktohet baza ligjore e aktivitetit të mbikqyrësit të punimeve, detyrat dhe të drejtat e palëve.

Neni 3

BAZA LIGJORE

Palët kontraktuese janë të angazhuara të zbatojnë me rigorozitet dispozitat e vendosura në ligjin nr.8402 dt.10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".



Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, V.K.M. VENDIM Nr. 354 dt.11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORIAL, PROJEKTIM, MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM" si edhe gjithë aktet e tjera ligjore të cilat nuk janë shprehimisht të cituara në kete kontrate.

Neni 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS

Bashkia Patos me cilësinë e investitorit ka për detyrim ndaj mbikqyrësit të punimeve:

- 1- Të lirojë e dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen .
- 2- Të vërë në dijeni mbikqyrësin për të gjitha ndryshimet që mund të pësojë dokumentacioni teknik, si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej mbikqyrësit.
- 3- Të bëjë pagesën e plotë të mbikqyrësit shoqërise "REAN 95" shpk Tirane me nr.Nipti J61827043V perfaqesuar nga Ing.Razije Naipi e licensuar me nr.licence MK.1506/6 dt.01/08/2016 në bazë të rezultatit të nxjerrë nga sistemi pas zhvillimit të procedurës blerje me vlerë të vogël, në shumën 237,600(dyqind e tridhjetë e shtate mijë e gjashtëqind) leke me TVSH.
- 4- Të vërë në dijeni mbikqyrësin e punimeve per nënkontraktoret e mundshëm qe mund të zgjedhë sipërmarrësi për të realizuar punimet .

Po kështu investitori ka te drejte :

- 1 – Të kërkojë në çdo kohë informacion mbi bazën e akteve të përpiluara nga mbikqyrësi i punimeve për punët në objekt.
- 2 – Të zëvendesojë mbikqyrësin e punimeve kur verëhen mangësi serioze në veprimtarinë e tij.

Neni 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE


Mbikqyrësi i punimeve në të gjithë veprimtarinë e tij do të bazohet në aktet ligjore të lartpërmendura, si edhe në kërkesat e kësaj kontrate ku vecojmë :

Mbikqyrësi i punimeve ka të drejta :

- 1 – Të fillojë pune pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit tek sipërmarrësi .
- 2 – Të marrë shpërblimin pas çdo situacioni të dorëzuar tek investitori .
- 3 – Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet .
- 4 – Të kërkojë prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit .

Po kështu mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë :

- 1 – Të ndjekë nga afër çdo punim që bëhet prej sipërmarrësit në objekt, në çdo fazë të tij
- 2 – Të mbajë konform Udhëzimit nr.3 dt.15/02/2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në çdo moment që i kërkohet prej investitorit .
- 3 – Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentave që pasqyrohen atje.
- 4 – Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kërkuara për kantierin në përputhje me kërkesat e rregullave të prokurimit të sanksionuara në pikën 6.1 të shtojcës 15 të DST, licencën e sipërmarrësit, verifikimin e sheshit të ndërtimit, njohjen e kontratës së sipërmarrjes, vendosjen e tabelës së identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin përkatës (pika 6 e Udhëzimit nr 3 dt.15.2.2001)
- 5 – Të bëjë informimin me shkrim njëherë në muaj dhe rast pas rasti për të gjitha masat e marra prej tij të zbatimit të projektit të punimeve prej sipërmarrësit, cilësinë e materialeve të



përdorura në punime, për masat me karakter administrativ që i ka propozuar për t'i marrë sipërmarresit, verifikimet përkatëse që ka kërkuar në raste të defekteve në punime etj.

6 - Të mos lejoje asnjë punim të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Në rast të kundërt duhet të ndërmarrë inisiativen e nevojshme që i lejon ligji dhe aktet nënligjore të lartepërmendura për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.

7 - Të kërkoje prej sipërmarresit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me perfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal për dorezimin e dosjes së punimeve.

8 - Të mbajë kontakte të vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe të marrë pjesë në kolaudimin e vepres së perfunduar. Të firmosë gjithshka që ka miratuar duke vlerësuar se mban përgjegjësi ligjore për këto akte.

9 - Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarresit, dhe pas kësaj ato vlerësohen të vlefshme për t'u bërë pagesa përkatëse.

10 - Pas perfundimit të kolaudimit përcakton vlerën perfundimtare të objektit që i jepet për likuidim investitorit.

11 - Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikqyresit dhe zbatuesit i punimeve bëjnë kontrollin perfundimtar të vepres. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe ben ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Neni 6

SANKSIONET

Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbahen kushteve të kësaj kontrate dhe të respektojnë të gjithë legjislacionin e lartepërmendur.

Mos zbatimi dhe shkeljet që mund të ndodhin gjatë periudhës së punimeve i ngarkon palët me sanksione dhe deri në zgjidhjen e kësaj kontrate.

Neni 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët e përfshira në këtë kontratë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në rast se nuk do të mundin t'i zgjidhin ato, me mirëkuptim.

Neni 8

DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nënshkrimit të saj prej palevë pjesëmarrëse.

Kontrata përpilohet në 5(pese) kopje ku njëra depozitohet në dosjen e tenderit, një kopje pranë Mbikqyresit të punimeve, një kopje pranë sipërmarresit dhe dy kopje në Drejtorinë e Finances pranë Bashkisë Patos.

INVESTITORI
BASHKIA PATOS


KRYETARE
Rajmonda BALILAJ



MBIKQYRESI I PUNIMEVE

Shoqeria "REAN95" shpk Tirane

licence MK.1506/6dt.01/08/2016
perfaqesuar nga Ing.RAZIJE NAJPI





REPUBLICA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 684/13 Prot

Patos, më 09/08/2016

KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :

"RIKONSTRUKSION I RRUGES RUZHDIË-GJINOQAR"

Drejtuar : _____

PALËT :

❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS

KONTRAKTOR : "Shoqeria "Company Riviera 2008" shpk Tirane ne kontrate bashkepunimi me shoqerine "Vllaznia"shpk Tirane



KONTRATE SIPERMARRJE

“Rikonstrukcion i rruges Ruzhdie-Gjinoqar”

Lidhur sot më, 09 /Gusht / 2016 (dy mijë e gjashtembdhjete) midis Bashkise Patos perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise *znj.Rajmonda Balilaj* nga njera anë dhe shoqerise “Company Riviera 2008” shpk Tirane perfaqesuar nga *Z.Agim Kola* ne kontrate bashkepunimi me shoqerine “Vllaznia” shpk Tirane, perfaqesuar nga *Z.Ylber Kalaja* nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PËRKUFIZIME:

“Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes.

“Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes.

“Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve, e vertetuar nga enti prokurues, konkretisht ky afat është 45 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

“Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

“Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

“Data e fillimit” eshte perfshire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të fillonte punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

“Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

“Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ne objektin **“Rikonstrukcion i rruges Ruzhdie-Gjinoqar”**

“Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës e konkretisht.

“Drejtuues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.



[Handwritten signature]

1154

“Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe qe kontrakon punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

“Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

“Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

“Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

“Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet, konkretisht është shoqëria “**Company Riviera 2008**” shpk Tirane perfaqesuar nga **Z.Agim Kola** ne kontrate bashkepunimi me shoqerine “**Vllaznia**”shpk Tirane, perfaqesuar nga **Z.Ylber Kalaja**.

“Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

“Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

“Llogaritja e afateve” do të thotë që të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

“Afati i Garancise se Punimeve” do të thotë periudha prej 20 muaj e cilë fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilës Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt që ka ardhur si pasojë e cilësisë së punimeve të kryer prej tij.

“Garancia e Punimeve”, eshte vlera prej 5% e vlefes së situacionit përfundimtar të miratuar.

Neni 1 : Objekti i kontrates

“**Rikonstrukcion i rruges Ruzhdie-Gjinoqar**” sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 2 : Vlefte dhe afati i kontrates

Vlefte e fituar ne tender per përfundimin e punimeve ne total eshte **37,002,999,7(tridhjetë e shtate milion e dy mije e nentëqind e nentëdhjetë e nente pike shtate) leke me TVSH**, dhe afati i kryerjes se punimeve eshte **5 (pese) muaj**.

Prokurimi i ketij Objekti behet me vlere te plote.

Kontraktori eshte i detyruar te perfundoje te gjitha punimet (volumet e parashikuara ne preventiv) sipas afateve te zbatimit te punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve perkatese.



Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale të mesiperme përfshihet TVSH, si dhe të gjitha detyrimet e tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3: Hartimi i kontrates

Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikët e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.


Neni 6: Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikët dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo



1156
prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet



Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin. Gjithashtu kontraktori duhet të vendos në kantierin e punimeve tabelen me të dhenat kryesore të punimeve që do të kryhen.

Neni 17: Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit



Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospëmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kontratë deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumat e shprehura në KVK për



[Handwritten signature]

1155

humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrasi kostën e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për kostën e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës



11/0

Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provoje ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitor (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit



Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.



Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbejnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.



Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njesi ose në Total


Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimit, testimit dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japë udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.



Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Transferimi i të Drejtave

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 43: Sigurimi i Kontrates

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.



116

Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 44: Te drejtat dhe detyrat e AK

Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoi atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Patos do te vendosen si perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposhtme :

- Mbikqyresi i punimeve **"ARGI" shpk Tirane perfaqesuar nga Ing. Llambi Tarka.**

te marre te gjitha masat per gatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoi ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.

Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.

Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.

Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.

Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuar në LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- d) Korrigjime në materiale
- e) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor



ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.

Te vëri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.

Verifikon kryrjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eleminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- c) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- d) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 45: Te drejatat dhe detyrimet e kontraktorit

Te siguroj Kontraten ne vleren **10%** te vlefte totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.

Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.

Me marrjen e Objektivit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit ne dorezim.**

Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.

Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.

Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **5(pese)muaj**.


Te pranoj cdo ndryshim jo thellesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.

Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.

Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve.

Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti



1166

Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**

Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.

Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Sitauacionet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.

Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.

Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.

T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithë dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, të cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerite specifikisht sipas vertetimeve bankare qe do te paraqesin.

Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.

Neni 46: Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 47: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dëshmojnë se zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 48: Përfaqësimi i Palëve



1162

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 49: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 50: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo Kontrate hartohet në 5(pese) kopje, 2(dy) për Kontraktorin dhe 3(tre) për Bashkinë Patos dhe pasi lexohet nga palet, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire në Patos sot me datë 09/08/2016

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Naftëtari",

Rruga "Unaza" Patos

Tel: 0381 22372; 23664

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA PATOS

Rajmonda BAZILAJ

KRYETARI I BASHKIS



Adresa :

"Company Riviera 2008" shpk Tirane me adrese: Tirane, Kamez Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, kthesa e Valiasit nr.1, në zonë kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/35.

"Vllaznia" shpk Tirane me adrese: Tirane, Dajti lagja Qesarake, godine banimi dhe shërbimesh

"Company Riviera 2008" shpk Tirane Cel: 067 205 70 79

"Vllaznia" shpk Tirane Tel Fiks: 02366861

Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

Shoqëria "Company Riviera 2008" shpk Tirane në kontratë bashkepunimi me shoqërinë "Vllaznia" shpk Tirane

"COMPANY RIVIERA 2008 sh.p.k Tirane

Agim KOLA

PERFAQESUES I LGJORB

"VLLAZNIA" shpk Tirane

Ylber KALAJA

PERFAQESUES I LGJORB

"DAJTI PARK 2007"

TIRANE - ALBANIA





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 684 / Prot.

Patos, më 28.07/2016

KONTRATË

Mbi mbikqyrjen e punimeve per objektin

"Rikonstruksion i rruges "Ruzhdie-Gjinoqar"

Sot, më 28.07, 2016, bazuar ne ligjin Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", U.K.M.nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", ne V.K.M. nr.704 dt.29/10/2015 "Per tarifat e studimit, projektimit, drejtimet e kolaudimit te veprave te ndertimit ", ne U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.51 date 26/12/2015 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Patos per vitin 2015", në Udhëzimin nr.3 datë 27/01/2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla", në Urdhrin e Prokurimit nr.95 datë 15/07/2016 si edhe në kontratën qe do te lidhet me shoqerine "COMPANY RIVIERA 2008" shpk Kamez, Tirane me nr.Nipt-iK81716011V & "VLLAZNIA" sh.p.k Tirane me nr.Nipt-i K11507003S, lidhet kjo kontratë për caktimin e mbikqyrësit të punimeve me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

PALET KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata për caktimin dhe detyrat e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit për objektin "Rikonstruksion i rruges "Ruzhdie-Gjinoqar", midis investitorit Bashkia Patos e perfaqesuar prej Kryetares së saj njëkohesisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe shoqërise "ARGI" shpk Tirane me nr Nipti K62028003A perfaqesuar nga Ing.Llambi Tarka.e licensuar me nr.liçence MK.1666 date 02/03/2009 e cili rezultoi fituese nga procedura elektronike e blerjes me vlerë të vogël zhvilluar më datë 22/07/2016 ora 11:00. e cila me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyrën e ngarkuar të mbikqyrësit të punimeve të ndertimit, prej firmës sipërmarrëse fituese të tenderit "shoqerine "COMPANY RIVIERA 2008" shpk Kamez, Tirane me nr.Nipt-iK81716011V & "VLLAZNIA" sh.p.k Tirane.

Neni 2

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate janë marredheniet juridike qe krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e punimeve të ndërtimit për objektin "Rikonstruksion i rruges "Ruzhdie-Gjinoqar.Në këtë kontratë përcaktohet baza ligjore e aktivitetit të mbikqyrësit të punimeve, detyrat dhe të drejtat e palëve

Neni 3

BAZA LIGJORE

Palët kontraktuese janë të angazhuara të zbatojnë me rigorozitet dispozitat e vendosura në ligjin nr.8402 dt.10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit".



1152

Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, V.K.M. nr.704 dt.29/10/2014 "Për tarifën e studimit, projektimit, drejtimit e kolaudimit të veprave të ndërtimit" si edhe gjithë aktet e tjera ligjore të cilat nuk janë shprehimisht të cituara në këtë kontratë .

N e n i 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS

Bashkia Patos me cilësinë e investitorit ka për detyrim ndaj mbikqyrësit të punimeve:

- 1- Të lirojë e dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen .
- 2- Të vërë në dijeni mbikqyrësin për të gjitha ndryshimet që mund të pësojë dokumentacioni teknik, si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej mbikqyrësit .
- 3- Të bëjë pagesën e plotë të mbikqyrësit shoqërisë "ARGI" shpk Tirane me nr Nipti K62028003A perfaqesuar nga Ing.Llambi Tarka,e licensuar me nr.licence MK.1666 date 02/03/2009 në bazë të rezultatit të nxjerrë nga sistemi pas zhvillimit të procedurës blerje me vlerë të vogël, në shumën 336,000(treqind e tridhjetë e gjashtë mijë)leke me TVSH.
- 4- Të vërë në dijeni mbikqyrësin e punimeve për nënkontraktoret e mundshëm që mund të zgjedhë sipërmarrësi për të realizuar punimet .

Po kështu investitori ka të drejte :

- 1 – Të kërkojë në çdo kohë informacion mbi bazën e akteve të përpiluara nga mbikqyrësi i punimeve për punët në objekt.
- 2 – Të zëvendësojë mbikqyrësin e punimeve kur verëhen mangësi serioze në veprimtarinë e tij.

N e n i 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE


Mbikqyrësi i punimeve në të gjithë veprimtarinë e tij do të bazohet në aktet ligjore të lartpërmendura, si edhe në kërkesat e kësaj kontrate ku vecojmë :

Mbikqyrësi i punimeve ka të drejta :

- 1 – Të fillojë punë pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit tek sipërmarrësi .
- 2 – Të marrë shpërblimin pas çdo situacioni të dorëzuar tek investitori .
- 3 – Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet .
- 4 – Të kërkojë prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit .

Po kështu mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë :

- 1 – Të ndjekë nga afër çdo punim që bëhet prej sipërmarrësit në objekt, në çdo fazë të tij
- 2 – Të mbajë konform Udhëzimit nr.3 dt.15/02/2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në çdo moment që i kërkohet prej investitorit .
- 3 – Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentave që pasqyrohen atje.
- 4 – Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kërkuara për kantierin në përputhje me kërkesat e rregullave të prokurimit të sanksionuara në pikën 6.1 të shtojcës 15 të DST, licencën e sipërmarrësit, verifikimin e sheshit të ndërtimit, njihjen e kontratës së sipërmarrjes, vendosjen e tabelës së identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin përkatës (pika 6 e Udhëzimit nr 3 dt.15.2.2001)
- 5 – Të bëjë informimin në shkrim njëherë në muaj dhe rast pas rasti për të gjitha masat e marra prej tij gjatë zbatimit të projektit të punimeve prej sipërmarrësit, cilësinë e materialeve të



përdorura në punime, për masat me karakter administrativ që i ka propozuar për t'i marrë sipërmarresit, verifikimet përkatëse që ka kërkuar në raste të defekteve në punime etj.

6 - Të mos lejoje asnjë punim të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Në rast të kundërt duhet të ndërmarrë iniciativën e nevojshme që i lejon ligji dhe aktet nënligjore të lartepërmendura për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.

7 - Të kërkojë prej sipërmarresit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me përfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal për dorëzimin e dosjes së punimeve.

8 - Të mbajë kontakte të vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe të marrë pjesë në kolaudimin e vepres së përfunduar. Të firmosë gjithshka që ka miratuar duke vlerësuar se mban përgjegjësi ligjore për këto akte.

9 - Kontrollojë dhe miratohet situacionet e paraqitura nga sipërmarresit, dhe pas kësaj ato vlerësohen të vlefshme për t'u bërë pagesa përkatëse.

10 - Pas përfundimit të kolaudimit përcakton vlerën përfundimtare të objektit që i jepet për likuidim investitorit.

11 - Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikqyresit dhe zbatuesit i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të vepres. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit kostot e ndreqjes së tyre dhe ben ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Neni 6

SANKSIONET

Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbahen kushteve të kësaj kontrate dhe të respektojnë të gjithë legjislacionin e lartepërmendur.

Mos zbatimi dhe shkeljet që mund të ndodhin gjatë periudhës së punimeve i ngarkon palët me sanksione dhe deri në zgjidhjen e kësaj kontrate.

Neni 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët e përfshira në këtë kontratë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në rast se nuk do të mundin t'i zgjidhin ato, me mirëkuptim.

Neni 8

DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nënshkrimit të saj prej palevë pjesëmarrëse.

Kontrata përpilohet në 5(pese) kopje ku njëra depozitohet në dosjen e tenderit, një kopje pranë Mbikqyresit të punimeve, një kopje pranë sipërmarresit dhe dy kopje në Drejtorinë e Finances pranë Bashkisë Patos.

INVESTITORI

BASHKIA PATOS

KRYETARE

Rajmonda BALILAJ



MBIKQYRESI I PUNIMEVE

Shoqëria "ARGI" shpk Tirane

Nr.Lic MK MK.1666 date 02/03/2009

perfaqesuar nga Ing.Llambi Tarka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 700/118 Prot.

Patos, më 29 KO 2014

KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :

**“RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME “ZHANI CIKO”
PATOS**

Drejtuar : Shoqerise “4 A-M ” sh.p.k TIRANE

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS
- ❖ KONTRAKTOR : SHOQERIA “4 A-M ” sh.p.k TIRANE



KONTRATE SIPERMARRJE

“RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME : “ZHANI CIKO” PATOS

Lidhur sot më, **29/TETOR/ 2014 (dy mijë e katermbedhete)** midis **Bashkise Patos** perfaqesuar nga Kryetare e Bashkise **znj.Rajmonda Balilaj** nga njera anë dhe shoqerise **“4 A-M ” sh.p.k TIRANE**, me perfaqesues ligjor te saj **z. Ardit Metaliaj** nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PËRKUFIZIME:

1. **“Kontrate”** do te thote Kontrate Siper marrje, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. **“Vlefte e Kontrates”** eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates **02/09/2014** te organizuar ne Bashkine Patos per ndertimin e ketij Objekti.
3. **“Objekt”** do te thote **“Rikonstruksion i shkolles se Mesme “Zhani Ciko”** Patos, Shqiperi, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
3. **“Autoriteti Kontraktor”** eshte **BASHKIA PATOS**.
4. **“Kontraktor”** eshte shoqeria **“4 A-M” sh.p.k. Tirane**, me perfaqesues ligjor te saj **z.Ardit Metaliaj**.
5. **“4 A-M” shpk Tirane** gezon personalitet juridik e ligjor pasi rezulton i regjistruar sipas ekstraktit te QKR me nr. NIPT **K92005016L** qe prej dates **05/08/2009** dhe License Zbatimi te Punimeve NZ.6546/5date **19.08.2013**
6. **“Preventiv”** do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje. Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. **“Situacion Pjesor”** do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. **“Situacion Perfundimtar”** do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuar ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimi i fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. **“Data e kryerjes se plote”** do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. **“Kryerja”** do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. **“Difekt”** do te thote cdo pjese e ndertimeve e parealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. **“Data e hyrjes”** do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.



13. **“Materiale”** do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trpezimin e tyre ne ndertimin e objektit.
14. **“Standarte Teknike”** do të thotë specififikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
15. **“Mbikqyresi i punimeve”** (Supervizori) do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje per ndertimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar, U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit” dhe paraqiten ne Kontraten e Mbikqyrjes.
16. **“Kolaudatori”** do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate per Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar dhe paraqiten ne Kontraten e Kolaudimit.
17. **“Ndertime”** do te thote Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjese perberese e Kontrates.
18. **“Llogaritja e afateve”** Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.
19. **“Afati i Garancise se Punimeve”** do te thote periudha prej **24 muaj** e cila fillon nga data e aktit te kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasoje e cilesise se punimeve te kryer prej tij.
20. **“Garancia e Punimeve”**, eshte vlere prej **5%** e vlefes se situacionit perfundimtar te miratuar.
21. **“Baza ligjore”** Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfshire te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Kontraktorit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.
22. **“Force Madhore”** do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfshihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri, permbytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.


I. OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kesaj kontrate eshte **“Rikonstruksion i shkolles se Mesme “Zhani Ciko”Patos** sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate. Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte **42,966,760.8 (dyzete e dy milion e nenteqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e gjashtedhjetë pike tete)** leke me TVSH, dhe afati i kryerjes se punimeve eshte **6 muaj (180 ditë kalendarike)**.

Prokurimi i ketij Objekti ne baze te vendimit nr. 6 date 10.06.2014 te Komitetit per Zhvillimin e Rajoneve prokurohet me vlere te plote, por per vitin 2014 do te financohet ne vleren **20,712,154 (njetzetë milion e shtateqind e dymbedhjetë mijë e njetqind e pesedhjetë e kater)** leke me TVSH, pjesa tjeter do te financohet ne vitet ne vazhdim.



Kontraktori është i detyruar të perfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse pavarësisht financimit.

Kontraktori është i detyruar të perfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Në vleften totale të mesiperme përfshihet TVSH, si dhe të gjitha detyrimet e tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK

1. Te njohë zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorëzojë atij nga një kopje të Kontrates së Mbikqyrjes dhe Kontrates së Kolaudit. Nga ana e Bashkisë Patos do të vendosen si përfaqësues pranë sipërmarresit, persona të autorizuar prej Kryetarit të cilet do të jenë me çelës dhe meposhtme :
 - Mbikqyresi i punimeve ECUALA, Person fizik, të marrë të gjitha masat përgatitore për lirim të Sheshit të Nderimit dhe të lejojë Kontraktorin të hyjë në Objekt dhe ta dorëzojë atë me proces-verbal në prani të Mbikqyresit.
2. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.
3. Brenda Dates së Hyrjes të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme ligjore në mënyrë që t'i krijojë kushte pune normale Kontraktorit.
4. Të miratojë Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar të paraqitur e të miratuar nga Mbikqyresi.
5. Të asistojë në procesin e kolaudit perfundimtar të Objektivit.
6. Ka të drejtë që për të realizuar me sa më mirë anën funksionale të Objektivit, të bëjë ndryshime jo thelbësore në Projektin e Zbatimit dhe në Preventivin e Zbatimit. Nderimet shpesh mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe U.K.M. Nr.2 datë 13.02.2005 "Për zbatimin e punimeve të nderimit" dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.
7. Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:
 - a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - b) Korrigjime në materiale
 - c) Korrigjime në sasi
8. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrëveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.

Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një procesverbal (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të



bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

9. Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.
10. Te vëri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.
11. Verifikon kryrjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eleminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.
12. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.


IV. TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)

1. Te siguroj Kontraten ne vleren **10%** te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit të punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
3. Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
4. Me marrjen e Objektivit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit ne dorezim.**
5. Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.
6. Menjëherë pas lidhjes së kontratës, Kontraktori duhet t'i paraqesë mbikqyresit te punimeve një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
7. Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.





- 1024
8. Te njoh, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
 9. Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **6 muaj (180 dite kalendarike)**.
 10. Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
 11. Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.
 12. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyt e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.
 13. Autoriteti Kontraktor, mund te jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
 14. Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**
 15. Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.
Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.
Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.
 16. Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situaconet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
 17. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese) dite** para dates se perfundimit te punimeve.



18. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
19. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
20. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditësuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

V . PRONA INTELEKTUALE

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakort ndryshe, Sipërmarrësi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës. Sipërmarrësi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Sipërmarrësi duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur të furnizuar sipas kontratës, Sipërmarrësi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

VI. TESTIMET DHE INSPEKTIMET

Sipërmarrësi është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt, si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyresit i Punimeve.

Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi, brenda kushteve të çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu duhet t'i kërkojë Sipërmarrësit të bëjë teste dhe inspektime shtesë të pa parashikuara në kontratë, por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.



Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim ndërtimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve, as inspektimi i punimeve të ndërtimit nuk do ta lirojë Sipërmarrësin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

VII. NGRITJA E KANTIERIT

Sipërmarrësi do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes së Kantierit.

Sipërmarrësi duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

VIII. ZBULIMET

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Sipërmarrësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin e Punimeve për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e mbikqyrësit të punimeve për procedurën e administrimit të objekteve.

IX. SIGURIMI TEKNIK DHE MJEDISOR

Sipërmarrësi është përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier duke zbatuar masat korrigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për të gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

X . RREZIQET E KONTRAKTORIT DHE FORCA MADHORE

Kontraktori ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të kontratës. Kontraktori deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe pajisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

Kontraktori nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcave Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktor dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.



Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin e kontratës deri sa nuk pengohet nga Forca Madhore.

XI. NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

XII. KONTROLLI I CILESISE

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

XIII. MARRJA NE DOREZIM E PUNIMEVE

Kontraktori pas perfundimit te punimeve njofton me shkrim Mbikqyresin e Punimeve dhe Autoritetin Kontraktor. Nese Mbikqyresi nuk ka verejtje ky njoftim shenon daten e perfundimit te punimeve. Kontraktori pas njoftimit te perfundimit te punimeve i paraqet brenda 30 diteve Mbikqyresit te Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare per punimet e kryera. Mbikqyresi i Punimeve, mbas verifikimeve, brenda 30 diteve se bashku me relacionin e tij ia paraqet te gjithe dokumentacionin Autoritetit Kontraktor.

Mbas marrjes se gjithe dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit te kolaudimit gjithe dokumentacionin e realizimit te objektit. Me perfundimin e procedureve te kolaudimit Autoriteti Kontraktor leshon certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve te kryera dhe do te ciliroje garancine e sigurimit te kontrates. Nga data e akt-kolaudimit te punimeve fillon periudha e garancise se punimeve.

Ne fund te periudhes se garancise se punimeve, Mbikqyresi i Punimeve dhe komisioni i marrjes ne dorezim te objektit do te perpilojne se bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes ne dorezim te vepres, objekt i kesaj kontrate.



XIV. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim në adresat e deklaruar nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.
2. Shoqeria "4 A-M" Shpk Tirane merr persiper te gjitha pergjegjësitë dhe detyrimet perpara Bashkise Patos , si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjiesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrije, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
3. Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
4. Ne qofte se Kontraktori braktis Objektin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Patos dhe Garancine e Kontrates.
5. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj.
6. Palet nuk çlirohen nga cdo pergjegjesi per mos zbatimin e termave te kesaj Kontrate, pervec se ne rast te veprimit te forcave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
7. Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Drejtorine e Sherbimeve Publike dhe Mirembajtjes Urbane te Bashkise Patos, pasi ky i fundit do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithe procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.
8. Per cdo dite vonese tej afatit te punimeve, Kontraktori eshte i detyruar t'i paguaj Autoritetit Kontraktor, **gjobe ne masen 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
9. Në qoftë se Sipërmarrësi nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Sipërmarrësi do të paguajë këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Autoriteti Kontraktor do të mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.
10. Nëse me përfundimin e periudhës së garancisë Sipërmarrësi nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara, Autoriteti Kontraktor i zbrit nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.
11. Shperblimi per demet e shaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
12. Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerine "4 A-M" shpk Tirane sh.p.k Fier, ne numrin e llogarise te Sipermarresit ne perputhje me vertetimin bankar qe do te sjelle shoqeria prane zyres se Finances, Bashkia Patos.



13. Çdo mosmarrveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, palet do të zgjidhin me mirekuptim, në të kundërt do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Fier.
14. Pjesë perberese e kësaj Kontrate janë edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime që është paraqitur në tender nga Sipermarresi si dhe Specifikimet Teknike të punimeve të pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
15. Çertifikata e Garancisë së Punimeve leshohet pas perfundimit të Afatit të Garancisë që është **24 muaj**, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kanë inspektuar Objektin dhe kanë konstatuar që nuk ka defekte dhe punime të pakryera si dhe që ai funksionon në përputhje me Projektin.
16. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë Afatit të Garancisë së punimeve të ndërtimit, AK llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bënë ndalesën nga vlera e Garancisë së punimeve që është në masën **5%** të vlerës totale të Kontrates.
17. Çmimet e punimeve do të jenë ato të fituara në tender, sipas preventivit të paraqitur nga Sipermarresi.
18. Bashkia Patos mund të bejë në çdo kohë porosi tek Kontraktori për të bërë ndryshime (specifikime teknike) brenda qelimit të përgjithshëm të kontratës.
19. Kontraktori është i detyruar që të njoftojë dhe të rakordojë përpara, në vazhdim dhe në perfundim të punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a për zgjidhjen bashkarisht të problemeve të infrastruktures së tyre, që të jenë prezente me specialistet e tyre kur do të kryhen punime të cilat kanë të bëjnë me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesiperme. Afati i njoftimit për këto subjekte do të jetë 5 (pese) dite përpara kryerjes së punimeve.
20. Kjo Kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje, 1 (një) për Kontraktorin, 4 (kater) për Bashkinë Patos dhe 1 (një) për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pasi lexohet nga palet, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lirë në Patos sot me datë 29/10/2014.

Adresa :

Bashkia Patos, Lagja "Nafitëtar",
Rruga "Unaza" Patos

www.bashkiapatos.gov.al

Adresa :

Shoqëria "4A-M" shpk Tirane
Rruga "Musa Agolli" Tirane

Nr.kontakti Cel :069 20 78 700

Për dhe në emër të :

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA PATOS

Rajmonda BALILAJ

KRYETARE E BASHKISË



KONTRAKTORI

Shoqëria "4A-M" shpk Tirane

Ardit METALLAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
Njësia e Prokurimit

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza";

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **"Rikonstrukcion i shkolles se Mesme "Zhani Ciko" Patos**
Nr. i Referencës së Kontratës se Sipermarrjes : REF-21.30.07.2014

Kjo Kontratë është lidhur më date **29/10/ 2014 (dy mijë e katermbedhjete)**, midis Bashkise Patos, Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza" tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe shoqerise **"4 A-M" shpk Tirane** me NIPT **K92005016L**, perfaqesuar ne kete kontrate nga Perfaqesuesi ligjor i saj z.Ardit Metaliaj, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **02/09/2014** bie dakord të kryeje punimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- këtë Formular Kontrate
- Formulari i Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej: **me TVSH 42,966,760.8 (dyzete e dy milion e nenteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e shtateqind e gjashtedhjete pike tete) leke**, dhe pa TVSH prej **35,805 634(tridhjete e pese milion e teteqind e pese mije e gjashteqind e tridhjete e kater) leke**.

Palët bien dakort si më poshtë :

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej 10 % te vleres se kontrates dhe në formën e: garanci bankare ose siguracion prane shoqerive te licensuara, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.



- 1001
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
 3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
 4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
 5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë **29/10/2014** palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS



Rajmonda BALILAJ
KRYETARE E BASHKISË



Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI
Shoqeria "4 A-M" shpk Tirane





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Nr. 700/21 Prot.

Patos, më 30/10/2014

K O N T R A T Ë

Mbi mbikqyrjen e punimeve te ndertimit per objektin
"Rikonstruksion i shkolles se Mesme "Zhani Ciko" Patos

Sot, më 30/10/2014 bazuar ne ligjin Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", U.K.M. nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", V.K.M. nr.444 dt.05.09.1994 "Per tarifat e studimit, projektimit, drejtimit e kolaudimit te veprave te ndertimit", ne U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", ne vendimin e Keshillit Bashkiak nr.48 date 17/10/2014 "Per shtim fondi per supervizim dhe kolaudim per proceduren me objekt "Rikonstruksion i shkolles se mesme "Zhani Ciko" Patos ",ne Udhezimin nr. 2 date 23.08.2013 "Per proceduren e prokurimit me vlere te vogla", ne Urdhrin e Prokurimit nr. 101 date 28/10/2014 si edhe ne kontraten e lidhur me shoqerine "4 A-M"shpk Tirane e cila merr persiper kryerjen e punimeve te ndertimit per objektin e mesiperm, lidhet kjo kontrate per caktimin e mbikqyresit te punimeve me permbajtjen si vijon:

Neni 1

PALET KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata per caktimin dhe detyrat e mbikqyresit te punimeve te ndertimit per objektin "**Rikonstruksion i shkolles se Mesme "Zhani Ciko" Patos**", midis investitorit Bashkia Patos e perfaqesuar prej Kryetares se saj njekohesisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe shoqerise "ECUALA" sh.pk Korce me nr. NIPT-i L06614601R, e licensuar me **nr.licence MK.1829/1 dt 03.12.2012** e cila rezultoi fituese nga procedura elektronike e blerjes me vlere te vogel zhvilluar me date 29/10/2014 ora 16:00, e cila me vullnet te lire pranon dhe merr persiper detyren e ngarkuar te mbikqyresit te punimeve te ndertimit, prej firmes sipermarrese fituese te tenderit "4 A-M"shpk Tirane , perfaqesuar nga Z. Ardit Metaliaj.

Neni 2


OBJEKTI

Objekti i kesaj kontrate jane marredheniet juridike qe krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikqyresit te caktuar per ndjekjen e punimeve te ndertimit per objektin "**Rikonstruksion i shkolles se Mesme "Zhani Ciko" Patos**". Ne kete kontrate percaktohet baza ligjore e aktivitetit te mbikqyresit te punimeve, detyrat dhe te drejtat e paleve.

Neni 3

BAZA LIGJORE

Palet kontraktuese jane te angazhuara te zbatojne me rigorozitet dispozitat e vendosura ne ligjin nr. 8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit",



12/18

Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar, Vendimin e K.M nr 444 dt. 05/09/1994 "Tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit te veprave te ndertimit" si edhe gjithe aktet e tjera ligjore te cilat nuk jane shprehimisht te cituara ne kete kontrate .

N e n i 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS

Bashkia Patos me cilesine e investitorit ka per detyrim ndaj mbikqyresit te punimeve:

- 1- Te liroje e dorezoje sheshin e ndertimit per punimet qe do te realizohen .
- 2- Te vere ne dijeni mbikqyresin per te gjitha ndryshimet qe mund te pesoje dokumentacioni teknik, si edhe te gjithe dokumentacionin e nevojshem te kerkuar prej mbikqyresit .
- 3- Te beje pagesen e plote te mbikqyresit, shoqerise "ECUALA" sh.p.k , ne baze te rezultatit te nxjerre nga sistemi pas zhvillimit te procedures blerje me vlere te vogel, ne shumen **1,199 (njemije e njeqind e nentedhete e nente) leke me TVSH.**
- 4- Te vere ne dijeni mbikqyresin e punimeve per nenkontraktoret e mundshem qe mund te zgjedhe sipermarresi per te realizuar punimet .

Po keshtu investitori ka te drejte :

- 1 - Te kerkoje ne cdo kohe informacion mbi bazen e akteve te perpiluara nga mbikqyresi i punimeve per punet ne objekt.
- 2 - Te zevendesoje mbikqyresin e punimeve kur verehen mangesi serioze ne veprimtarine e tij.

N e n i 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE


Mbikqyresi i punimeve ne te gjithe veprimtarine e tij do te bazohet ne aktet ligjore te lartepermendura, si edhe ne kerkesat e kesaj kontrate ku vecojme :

Mbikqyresi i punimeve ka te drejta :

- 1 - Te filloje pune pas dorezimit te sheshit te ndertimit tek sipermarresi .
- 2 - Te marre shperblimin pas cdo situacioni te dorezuar tek investitori .
- 3 - Te kerkoje prej investitorit te gjithe dokumentacionin e nevojshem teknik qe ka lidhje me objektin ku punohet .
- 4 - Te kerkoje prej investitorit plotesimin e te gjitha kerkesave te parashikuara ne kontraten e sipermarrjes midis investitorit dhe sipermarresit qe lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipermarresit .

Po keshtu mbikqyresi i punimeve ka per detyre :

- 1 - Te ndjeke nga afer cdo punim qe behet prej sipermarresit ne objekt, ne cdo faze te tij .
- 2 - Te mbaje konform Udhezimit nr.3 dt.15/02/2001 te Keshillit te Ministrave te ndryshuar, te gjithe dokumentacionin e nevojshem dhe ta kete ate disponibel ne cdo moment qe i kerkohet prej investitorit .
- 3 - Te kontrolloje librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen atje.
- 4 - Te verifikoje qe ne fillim te punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kerkuara per kantierin ne perputhje me kerkesat e rregullave te prokurimit te sanksionuara ne piken 6.1 te shtojces 15 te DST, licencen e sipermarresit, verifikimin e sheshit te ndertimit, njohjen e kontrates se sipermarrjes, vendosjen e tabeles se identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin perkates (pika 6 e Udhezimit nr 3 dt.15.2.2001)
- 5 - Te beje informimin me shkrim njehere ne muaj dhe rast pas rasti per te gjitha masat e marra prej tij gjate zbatimit te projektit te punimeve prej sipermarresit, cilesine e materialeve te perdorura ne punime, per masat me karakter administrativ qe i ka propozuar per t'i marre sipermarresi, verifikimet perkatese qe ka kerkuar ne raste te defekteve ne punime etj.
- 6 - Te mos lejoje asnje punim te realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Ne rast te kundert duhet te ndermarre inisiativen e nevojshme qe i lejon ligji dhe aktet nenligjore te lartepermendura per te rivendosur situaten teknike te pranuar nga ligji.


PATOS


ECUALA
PROJEKTIM, INZHINIERI, KONTROLIM, KONTROLI
ALBANIA

- 7 - Te kerkoje prej sipermarresit te gjitha aktet e nevojshme qe kane te bejne me perfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal per dorezimin e dosjes se punimeve.
- 8 - Te mbaje kontakte te vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe te marre pjese ne kolaudimin e vepres se perfunduar. Te firmose gjithshka qe ka miratuar duke vleresuar se mban pergjegjesi ligjore per keto akte.
- 9 - Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipermarresi, dhe pas kesaj ato vleresohen te vlefshme per t'u bere pagesa perkatese.
- 10 - Pas perfundimit te kolaudimit percakton vleren perfundimtare te objektit qe i jepet per likuidim investitorit.
- 11- Ne perfundim te periudhes se garancise, investitori, kolaudatori ,mbikqyresi dhe zbatuesi i punimeve bejne kontrollin perfundimtar te vepres. Per difektet qe nuk jane ndrequr gjate periudhes se garancise se punimeve te ndertim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlera e garancise se punimeve .

Neni 6

SANKSIONET

Palet kontraktuese jane te detyruara ti permbahen kushteve te kesaj kontrate dhe te respektojne te gjitha legjislacionin e lartepemendur.
Mos zbatimi dhe shkeljet qe mund te ndodhin gjate periudhes se punimeve i ngarkon palet me sanksione dhe deri ne zgjidhjen e kesaj kontrate .

Neni 7

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Palet e perfshira ne kete kontrate kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier per te zgjidhur mosmarreveshjet e tyre, ne rast se nuk do te mundin t'i zgjidhin ato, me mirekuptim .

Neni 8

DISPOZITA TE FUNDIT


Kjo kontrate fiton fuqine e nevojshme juridike e detyruese pas nenshkrimit te saj prej paleve pjesemarrese.


Sipas autorizimit nr. 30/2 prot date 30/10/2014 prej shoqerise "ECUALA" sh.p.k, per nenshkrimin e kesaj kontrate autorizohet Z. Erion Thomai me nr. identifikimi 029062852. Kontrata perpilohet ne 5 (pese) kopje ku njera depozitohet ne dosjen e tenderit, nje kopje prane Mbikqyresit te punimeve, nje kopje prane sipermarresit dhe dy kopje ne Drejtorine e Finances prane Bashkise Patos .

INVESTITORI
BASHKIA PATOS
KRYETARE
Rajmonda BADILAJ



MBIKQYRESI I PUNIMEVE
Shoqeria "ECUALA" sh.p.k
neshkruhet prej z. Erion THOMAI
sipas autorizimit





BASHKIA PATOS

Adresa: Lagjia Naftetari, Rruga Unaza
Tel: +355 34 20845/46/47/48 Fax: +355 34 20850

Kodipostar: 9307

Web: <http://www.bashkiapatos.gov.al>

RAPORT JAVOR SUPERVIZIMI PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURE TË INVESTIMEVE NE BASHKINE PATOS

Ju lutemi plotësoni këtë formular dhe dërgojeni prane zyrave te Bashkise me fotot bashkëngjitur

TITULLI I PROJEKTIT:		DATA:
KONTRAKTORI PËR SUPERVIZIMIN:	KONTRAKTORI PËR NDËRTIMIN:	

PUNË TË ZBATUARA GJATË PERIUdhËS SË RAPORTIMIT (ju lutemi bashkëngjisni foto për secilën kategori)

Përshkrimi i punës	Fotonr	Përqindja ndaj përfundimit të projektit	Probleme/pyetje/vërejtjerethcilësisëetj.

NDRYSHIME TË PROJEKTIT/ÇËSHTJE TË DISKUTUARA GJATË JAVËS SË RAPORTIMIT NËSE KA

Çështja (psh. Cilësia, afati, ndryshimet)	Zgjidhja/Ndryshimi i projektit/Rekomandime	Ndikiminëafatin e punimeve(nr. ijavëve)

Numri i javëve të realizuara të projektit	Përqindja e realizuar e projektit	Projektinëkohë/ivonuar/para kohe	Numri i javëve të mbetura

Komente Shtesë (psh. Sugjerime si të korigjohen vonesat, etj.)

--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 1726 / Prot
12

Patos, më 01 . 11 .2018

KONTRATË SIPËRMARRJE ME OBJEKT :

“Rikonstrukcion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti.”

Drejtuar : _____

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA PATOS
- ❖ KONTRAKTOR : “Shoqëria 4 A-M”shpk Tiranë



KONTRATË SIPËRMARRJE

“Rikonstruksion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti.”

Lidhur sot më, 01/11/2018 (dy mijë e tetembëdhjetë) midis **Bashkisë Patos** përfaqësuar nga Kryetare e Bashkisë **znj.Rajmonda Balilaj** nga njëra anë dhe shoqërisë “**4A-M**” sh.p.k Tiranë përfaqësuar nga **Z.Ardit Metaliaj** me nr Nipti **K92005016L**, të quajtur përkatësisht këtu e më poshtë, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

Neni 1: Qëllimi

Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

“Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.


“Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

“Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.



“Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

“Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

“Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.

“Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier përrealizimin e Ndertimeve.

“Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

“Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

“Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.


“Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

“Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet, konkretisht është shoqëria “4 A-M” sh.p.k Tiranë **përfaqësuar nga Z.Ardit Metaliaj** me nr Nipti **K92005016L**, rregjistruar pranë QKB si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

“Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

“Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.



Afati i Garancise se Punimeve” do të thotë periudha prej **24 muaj** e cila fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilës Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt që ka ardhur si pasojë e cilësisë së punimeve të kryer prej tij.

“Garancia e Punimeve”, është vlera prej **5%** e vlefës së situacionit përfundimtar të miratuar.

Neni 1: Objekti i kontrates

“Rikonstrukcion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti” sipas Projektit, Preventivit të miratuar me zëra e volume dhe specifikimeve teknike të pranuar në tender të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate dhe përbëjnë detyrim ligjor për zbatim nga palët në këtë kontrate.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 2: Vlefte dhe afati i kontratës

Vlefte e fituar në tender sipas preventivit fitues për përfundimin e punimeve në total është **68.160.302.8(gjashtëdhjetë e tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e dy pikë tetë) lekë me Tvsh**, dhe afati i kryerjes së punimeve është **6 muaj nga nënshkrimi i kontratës**. Prokurimi i këtij Objekti në bazë të Vendimin nr.7 datë 11.05.2018 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve prokurohet me vlerë të plotë, por për vitin 2018 **financimi do të jetë me vlerë 28.781.207 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatë) lekë me Tvsh** ku **3.509.903 (tre milion e pesëqind e nëntë mijë e nëntëqind e tre) lekë me Tvsh** e fondit të mësipërm do të *financohet nga Bashkia Patos*, kurse pjesa tjetër me vlerë **39.379,095(tridhjetë e nëntë milion e e treqind e shtatëdhjetë e nente mije e nentëdhjetë e pese) lekë me Tvsh do të financohet** për vitin **2019** ku **3.306,127 (tre milion e treqind e gjashtë mije e njëqind e njëzetë e shtatë) lekë me Tvsh do të financohet nga Bashkia Patos e fondit të mësipërm.**

Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse pavarësisht financimit.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.



Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtan ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.


Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.



Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.



Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit

Te siguroj Kontraten ne vleren **10%** te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.

Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 15 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.

Me marrjen e Objektit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektit ne dorezim.**

Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike per aktivitetet e Punimeve.

Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.

Duke u mbështetur në VKM Nr.408, Neni 4/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, duke filluar nga data 1 shtator 2016 ka filluar zbatimi i detyrueshëm i sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi si dhe për ecurinë e procedurave për verifikimin e dosjeve të objekteve që kanë përfunduar.

Ju lutemi të botoni elektronikisht cdo hap gjatë fazës së punimit pas marrjes së lejes së zhvillimit/ndërtimit në sistemin online e-leje (www.e-albania.al) në dritaret përkatëse:

- 1) Njoftim për fillimin e punimeve
- 2) Njoftim për raportin e mbikqyrjes
- 3) Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit

Bashkëngjitur njoftimit të ngarkohet dhe dokumentacioni i plotë për secilën faze.

Të njoh, të respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.

Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar .

Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.

Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Autoritetin Kontraktor per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Autoritetit Kontraktor per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.

Periodha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periodha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.



Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti

Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine punetore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitura ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ja jape nje subjekti tjetër.**

Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor.

Sipërmarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

Te paraqes tek AK per miratim dhe per te realizur likujdimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Sitacionet te jene te miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.


Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.

Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.

T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerite specifikesht sipas vertetimeve bankare qe do te paraqesin.

Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me CEZ, ALBTELECOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara.



Te drejtat dhe detyrat e AK

Te njohë zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Patos do te vendosen si perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposhtme :

– Mbikqyresi i punimeve **“HMK CONSULTING” shpk Tiranë**
të marrë të gjitha masat përgatitore për lirimin e Sheshit të Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne

Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.

Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.

Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.

Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.

Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuar në LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit” dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.


Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

Çdo ndryshim i urdhëruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.



Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.

Te vëri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.

Verifikon krytjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefata e Garancise se Punimeve.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë

zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.



Neni 18: Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërnmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.



Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.



Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së egzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të paguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës



Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.


Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse

Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.



Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit total të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- d) Korrigjime në materiale
- e) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes.

Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruar në amendamentet e marrveshjes.



Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

Neni 37: Preventivi per Njesi ose ne Total

Kontrata do të përfshijë një Preventiv ne Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv per Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nese është një kontratë me çmim njesie, Preventivi per Njesi do të përmbajë volumet e zerave te ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi per Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin ne Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- c) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- d) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj


Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.



Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Nënkontraktimi

Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 43: Transferimi i të Drejtave

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44: Sigurimi i Kontrates

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 45: Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhjen mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.



Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 47: Përfaqsimi i Palëve

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 49: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo Kontrate hartohet ne 5(pesë) kopje, 2(dy) per Kontraktorin dhe 3(tre) për Bashkinë Patos dhe pasi lexohet nga palët, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lirë në Patos sot më datë 21/11/2018.

Adresa :

"4-AM" sh.p.k Tirane me adrese si me poshte:

Rruga Artan Lenja ,Pallati i 4 A-M

Apartamenti A1 kati i I-rë.

Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

4 A-M" sh.p.k Tirane

Adresa :

Lagjja "Naftëtari" ,Rruga "Unaza",Patos

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA PATOS

Rajmonda BALILAJ

Ardit METALIAJ

PËRFAQËSUES I LIGJOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 2156/19 Prot.

Patos, më 01/11 /2018

K O N T R A T Ë

Mbi mbikëqyrjen e punimeve për objektin
“Rikonstruksion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti”

Sot, më 01.11, 2018, bazuar në ligjin nr.8402 dt.10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, U.K.M.nr.3dt.15/02/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, në Vendimin nr. 354, datë 11.5.2016 “Përmiratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, në U.K.M nr.2 dt.13.05.2005 Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.38 datë 21/12/2017 “Përmiratimin e buxhetit të Bashkisë Patos për vitin 2018”, në udhëzimin nr.3 datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar, në urdhrin e prokurimit Nr .35 dt 24.09.2018 si edhe në kontratën që do të lidhet me shoqërinë “4 A-M” Shpk Tiranë lidhet kjo kontratë për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

PALË T KONTRAKTUESE

Lidhet kontrata për caktimin dhe detyrat e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti” midis investitorit Bashkia Patos e përfaqësuar prej Kryetares së saj njëkohësisht Titullare e Autoritetit Kontraktor znj.Rajmonda Balilaj dhe shoqërisë “HMK-CONSULTING”sh.p.k Tiranë me adresë Tiranë Rruga Zef Jubani, pallati "Bjorn", sh 3/5, ap.C/1, hyrja 20 me nr.Nipt-L57129604Q përfaqësuar nga z.Gëzim Pajo e licënsuar me nr.licence Nr.Lic MK. 2720/5 datë 24.07.2017 e cila rezultoi fituese nga procedura elektronike e Kërkesë për Propozim e zhvilluar më datë 08.10.2018 ora 11:00, e cila me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyrën e ngarkuar të mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, prej firmës fituese të tenderit shoqërisë“4 A-M” Shpk Tiranë.

Neni 2

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate janë marrëdhëniet juridike që krijohen midis investitorit Bashkia Patos dhe mbikëqyrësit të caktuar për ndjekjen e punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9 –vjeçare Meleq Gostinishti”. Në këtë

Adresa: Lagjia “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, www.bashkiapatos.gov.al

HMK-Consulting Sh.p.k.
Aut. i mbikëqyrjes dhe kolaudimit
KODI I IDENTIFIKIMIT: 128641

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

1

kontratë përcaktohet baza ligjore e aktivitetit të mbikqyrësit të punimeve, detyrat dhe të drejtat e palëve.

Neni 3

BAZA LIGJORE

Palët kontraktuese janë të angazhuara të zbatojnë me rigorozitet dispozitat e vendosura në ligjin nr. 8402 dt.10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 dt.15/02/2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **VENDIM Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM**“ si edhe gjithë aktet e tjera ligjore të cilat nuk janë shprehimisht të cituara në këtë kontratë .

Neni 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT BASHKIA PATOS

Bashkia Patos me cilësinë e investitorit ka për detyrim ndaj mbikqyrësit të punimeve:

- 1- Të lirojë e dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen .
- 2- Të vërë në dijeni mbikqyrësin për të gjitha ndryshimet që mund të pësojë dokumentacioni teknik, si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar prej mbikqyrësit .
- 3- Të bëjë pagesën e plotë të mbikqyrësit të shoqërisë“**HMK-CONSULTING**” sh.p.k Tiranë me nr.Nipt- **L57129604Q** përfaqësuar nga përfaqësuar nga z.Gëzim Pajo me adresë Tiranë Rruga Zef Jubani, pallati "Bjorn", sh 3/5, ap.C/1, hyrja 20 e liçensuar me nr.liçence **Nr.Lic MK. 2720/5 datë 24.07.2017** në shumën **1,016,262.6 (një milion e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë gjashtë)** lekë me **TVSH**.
- 4- Të vërë në dijeni mbikqyrësin e punimeve për nënkontraktoret e mundshëm që mund të zgjedhë sipermarrësi për të realizuar punimet .

Po kështu investitori ka të drejte :

- 1 – Të kërkojë në çdo kohë informacion mbi bazën e akteve të përpiluara nga mbikqyrësi i punimeve për punët në objekt.
- 2 – Të zëvendësojë mbikqyrësin e punimeve kur verëhen mangësi serioze në veprimtarinë e tij.

Neni 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE

Mbikqyrësi i punimeve në të gjithë veprimtarinë e tij do të bazohet në aktet ligjore të lartpërmendura, si edhe në kërkesat e kësaj kontrate ku veçojmë :

Mbikqyrësi i punimeve ka të drejta :

- 1 – Të fillojë punë pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit tek sipermarrësi .
- 2 – Të marrë shpërblimin pas çdo situacioni të dorëzuar tek investitori .
- 3 – Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet.

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga“ Unaza”, www.bashkiapatos.gov.al



4 – Të kërkoj prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit.

Po kështu mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë :

Duke u mbështetur në VKM Nr.408, Neni 4/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, duke filluar nga data 1 shtator 2016 ka filluar zbatimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi si dhe për ecurinë e procedurave për verifikimin e dosjeve të objekteve që kanë përfunduar.

Ju lutemi të botoni elektronikisht çdo hap gjatë fazës së punimit pas marrjes së lejes së zhvillimit/ndërtimit në sistemin online e-leje (www.e-albania.al) në dritaret përkatëse:

- 1) Njoftim për fillimin e punimeve
- 2) Njoftim për raportin e mbikqyrjes
- 3) Leje për shtytjen e afatit të lejes së ndërtimit
Bashkëngjitur njoftimit të ngarkohet dhe dokumentacioni i plotë për secilën fazë.

Mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë

- 1) Të ndjekë nga afër çdo punim që bëhet prej sipërmarrësit në objekt, në çdo fazë të tij
- 2) – Të mbajë konform Udhëzimit nr.3 dt.15/02/2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në çdo moment që i kërkohet prej investitorit .
- 3) – Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentave që pasqyrohen atje.
- 4) – Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, siguracionet e kërkuara për kantierin në përputhje me kërkesat e rregullave të prokurimit të sanksionuara në pikën 6.1 të shtojcës 15 të DST, licencën e sipërmarrësit, verifikimin e sheshit të ndërtimit, njohjen e kontratës së sipërmarrjes, vendosjen e tabelës së identifikimit dhe pas verifikimeve harton dokumentacionin përkatës (pika 6 e Udhëzimit nr 3 dt.15.2.2001)
- 5) Të bëjë informimin me shkrim njëherë në muaj dhe rast pas rasti për të gjitha masat e marra prej tij gjatë zbatimit të projektit të punimeve prej sipërmarrësit, cilësinë e materialeve të përdorura në punime, për masat me karakter administrativ që i ka propozuar për t'i marrë sipërmarrësit, verifikimet përkatëse që ka kërkuar në raste të defekteve në punime etj.
- 6) Të mos lejoj asnjë punim të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij. Në rast të kundërt duhet të ndërmarrë iniciativën e nevojshme që i lejon ligji dhe aktet nënligjore të lartpërmendura për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.
- 7) Të kërkoj prej sipërmarrësit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me përfundimet e punimeve ku edhe mban procesverbal për dorëzimin e dosjes së punimeve.

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, www.bashkiapatos.gov.al



- 8) Të mbaj kontakte të vazhdueshme me kolaudatorin e punimeve dhe të marr pjesë në kolaudimin e veprës së përfunduar. Të firmos gjithçka që ka miratuar duke vlerëuar se mban përgjegjësi ligjore për këto akte.
- 9) Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, dhe pas kësaj ato vlerësohen të vlefshme për t'u berë pagesa përkatëse.
- 10) Pas përfundimit të kolaudimit përcakton vlerën pëfundimtare të objektit që i jepet për likuidim investitorit.
- 11) Në pëfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori ,mbikqyresi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin pëfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancise së punimeve .

Neni 6

SANKSIONET

Palët kontraktuese janë të detyruara ti permbahen kushteve të kësaj kontrate dhe të respektojnë të gjithë legjislacionin e lartpërmendur.

Moszbatimi dhe shkeljet që mund të ndodhin gjatë periudhës së punimeve i ngarkon palët me sanksione dhe deri në zgjidhjen e kësaj kontrate.

Neni 7

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Palët e përfshira në këtë kontratë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, në rast se nuk do të mundin t'i zgjidhin ato, me mirëkuptim

Neni 8

DISPOZITA TE FUNDIT

Kjo kontratë fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nënshkrimit të saj prej palevë pjesëmarrëse.

Kontrata përpilohet në 5(pesë) kopje ku njëra depozitohet në dosjen e tenderit, një kopje pranë Mbikqyresit të punimeve, një kopje pranë sipërmarrësit dhe dy kopje në Drejtorinë e Finances pranë Bashkisë Patos .

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE
HMK-CONSULTING” Sh.p.k Tiranë
 Nr.Lic MK .2720/5 datë 24.07.2017

ADMINISTRATORI
 Gëzim PAJO



INVESTITORI
BASHKIA PATOS
KRYETARE
 Rajmonda BALILAJ

